



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 143, Datë 16.07.2024**

**MBI**  
**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË**  
**SHOQËRISË “EGNATIA HYDROPOWER” SH.P.K. SI MJET PËR GARANTIMIN E**  
**DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1503/3 prot., datë 10.07.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. për dhënie autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 248, datë 29.09.2022, dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 238, datë 22.09.2022.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1503 prot., datë 11.06.2024, shoqëria ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredi dhënëse, “RAIFFEISEN BANK” sh.a.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar, me shkresën nr. 1503/1 prot., datë 27.06.2024, ERE i evidentoi shoqërisë informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit të saj.
- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1503/2 prot., datë 02.07.2024, shoqëria ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e munguar.
- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit rezultoi se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pikat 1 dhe 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi kuotat për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredi dhënëse, “RAIFFEISEN BANK” sh.a.
2. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
3. Shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**